

THIKA

Jorge Luis Borges

Në një sirtar kam një thikë. Është farkëtuar në Toledo, në fundin e shekullit të kaluar; Luis Melián Lafinur ia dha babait tim, që e solli nga Uruguai; Ekaristo Karriego e ka patur ndonjëherë në dorë.

Kush e sheh dëshiron të luaj pak me të; ndiejnë se kishin shumë që e kërkonin; dora ngutet të shtrëngojë dorezën që e pret; fleta e bindur dhe e pushtetshme luan me saktësi në këllëf.

Thika dëshiron diçka tjetër. Është më shumë se një strukturë e bërë me metal; njerëzit e menduan dhe e formuan për një fund shumë të saktë; është, në një mënyrë të përjetshme, thika që mbrëmë vrau një njeri në Takuaremba dhe thikat që vranë Çezarin. Don të vras, don të derdh gjak të freskët.

Në një sirtar të shkrimtarit, mes projekteve dhe letrave, pafundësisht ëndërron thika me ëndrrën e thjeshtë të tigrin, dhe dora merr zemër kur e udhëheq sepse metali vetë merr zemër, metali që parandien në çdo kontakt vrasjen për të cilën e krijuan njerëzit.

Nganjëherë më vjen keq. Shumë ashpërsi, shumë besim, shumë krenari e butë ose e pafajshme, dhe vitet kalojnë, të kotë.

Përktheu nga spanjishtja: Meri Lika